

Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

Carvago by Gjirafa Albania SH.P.K.

Kreu I

Themelimi, Objekti i veprimtarisë, Selia

Neni 1

Ortak i Vetëm

1.1 **Carvago by Gjirafa L.L.C.** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, regjistruar me numër shoqërie 812112887 me seli në Rruga Prishtinë-Ferizaj, Km 6, Graçanicë, Kosovë (referuar si më poshtë si “**Ortaku i Vetëm**”), përfaqësuar ligjërisht nga:

- a) **Mërgim Cahani**, Drejtor Menaxhues, shtetas shqiptar, i datëlindjes 19.03.1980, lindur në Kosovë, mbajtës i pasaportës me numër BA4288081, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe
- b) **Jakub Šulta**, Drejtor, shtetas çek, i datëlindjes 03.05.1988, lindur në qytetin Kadan të Republikës Ceke, mbajtës i pasaportës me numër 48538191, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **Carvago by Gjirafa Albania sh.p.k.** (“**Shoqëria**”) duke nënshkruar këtë Statut. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë.

Neni 2

Emri

2.1 Emri ligjor i Shoqërisë është **Carvago by Gjirafa Albania SH.P.K.**

Neni 3

Forma Ligjore

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Baza Ligjore

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (**"Ligji Tregtar"**), i ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

Neni 6

Selia/ Adresa e Regjistruar

- 6.1 Adresa e selisë së Shoqërisë është: Tiranë, Vorë, Tirana Business Park, Rruga Rinas.

Neni 7

Objekti

- 7.1 Shoqëria do të ketë të drejtën dhe autoritetin për të kryer, çdo lloj aktiviteti të lejuar nga ligji, duke përfshirë specifikisht: blerjen dhe shitjen e veturave dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse përmes një platforme online, si dhe shitjen e produkteve dhe/ose shërbimeve CEBIA në Republikën e Shqipërisë.

Kreu II

Neni 8

Kapitali

- 8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100, 000.00 (njëqind mijë) Lekë.
- 8.2 Ortaku i Vetëm **Carvago by Gjirafa L.L.C.** zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë në shumën e parashikuar në pikën 8.1 më sipër.

Neni 9

Transferimi i pjesës së kapitalit/ Kufizimet në transferim

- 9.1 Ortaku i Vetëm është zotëruesi i vetëm i kuotës të kapitalit të regjistruar.
- 9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretë përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 9.3 Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet përcaktohen në momentin e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, momentin e pagesës së çmimit, në kontratën e kalimit të kuotës, e cila hartohet në formë shkresore, sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

Neni 10

Zmadhimi i Kapitalit

- 10.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 10.2 Rritja e kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit të kuotave të reja të emetuara nga Shoqëria nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe të miratohen si të tillë me një vendim të Ortakut të Vetëm.
- 10.3 Kontributi i mëtejshëm i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, kuota apo të drejta). Mënyra e shlyerjes së kontributeve do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 11

Zvogëlimi i Kapitalit

- 11.1 Bazuar në vendimin e Ortakut të Vetëm, zvogëlim i kapitalit të regjistruar do të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm për shoqëritë tregtare.
- 11.2 Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e vlerës së kapitalit të kërkuar nga i zbatueshëm për shoqëritë tregtare.

Kreu III

Organizimi i Shoqërisë

Neni 12

Organet e Shoqërisë

- 12.1. Organet e Shoqërisë janë si vijon:
 - Ortaku i Vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
 - Administratorët – organi më i lartë ekzekutiv.
- 12.2. Ortaku i Vetëm mund të krijojë organe apo struktura të tjera ndihmëse për mbarëvajtjen e Shoqërisë.

Neni 13

Rregulloret e Brendshme

- 13.1. Në përputhje me rregullat, procedurat dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm Ortaku i Vetëm miraton rregullore të posaçme për organizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.
- 13.2. Rregulloret e përmendura në pikën 13.1 përfshijnë por pa u kufizuar:
 - a. Rregulloren për administrimin e shoqërive të grupit;
 - b. Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesit;
 - c. Kodi i etikës etj.

Struktura Drejtuese

Neni 14

Vendimet e Ortakut të Vetëm

- 14.1. Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë miratohen me vendim të Ortakut të Vetëm i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj. Vendimi i Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë në mënyrë që të dhënat të mos ndryshohen apo fshihen.
- 14.2. Vetëm Ortaku i Vetëm do të ketë të drejtë të vendos për çështjet e mëposhtme:
- a) modifikimin dhe ndryshimin e Statutit;
 - b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave);
 - c) të rrisë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
 - d) vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe/ose çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
 - e) të themelojë dhe/ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi;
 - f) të miratojë raportet vjetore dhe bilanci dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
 - g) të miratojë rregullat e brendshme të administrimit;
 - h) të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
 - i) të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë e paluajtshme;
 - j) të prishë Shoqërinë;
 - k) të vendosë pagën e Administratorëve;
 - l) të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël;
 - m) të miratojë emërimin e audituesve;
 - n) të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
 - o) të vendosë mbi punësimin, shkarkimin dhe mbi çdo çështje tjetër të lidhur me punësimin si promovime, bonuse etj të cilat i përkasin pozicioneve drejtuese në Shoqëri;
 - p) të miratojë hua ose dhënien e titujve;
 - q) të vendosë për çdo çështje tjetër që i takon për zgjidhje mbledhjes së aksionarëve, me ligj dhe/ose sipas këtij Statuti.

Neni 15

Administrimi i Shoqërisë

- 15.1. Në të gjithë veprimtarinë brenda dhe jashtë vendit Shoqëria përfaqësohet nga Administratorët që emërohen dhe zëvendësohen me vendim të Ortakut të vetëm.
- 15.2. Administratorët do të kenë kompetenca të plota për drejtimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe aftësinë për të miratuar të gjitha vendimet që i konsiderojnë të përshtatshme për të arritur dhe zbatuar objektin e Shoqërisë, me përjashtimin e vetëm të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti ose vendimeve të herë pas herëshme të Ortakut të Vetëm i takojnë Ortakut të Vetëm.
- 15.3. Administratorët kanë të drejtë të delegojnë nëpërmjet prokurës, pjesërisht ose plotësisht kompetencat e tyre një personi të tretë sipas miratimit paraprak me shkrim të Ortakut të Vetëm.

- 15.4 Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Statut, Administratorët kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- administrimin e përditshëm të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm, sipas rastit, të miratuara herë pas here;
 - përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
 - lëshimin e faturave, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë;
 - punësimin dhe shkarkimin e punonjësve të Shoqërisë dhe përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të punonjësve në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara, herë pas here, nga Ortaku i Vetëm;
 - kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - mbajtjen e librave kontabël në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
 - përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimin e tyre nga ekspertë kontabël të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 15.5 Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky Statut janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm.
- 15.6 Ortaku i Vetëm përcakton, me vendim përkatës, kufizimet e kompetencave, objektin e kompetencave për secilin administrator dhe, nëse është e nevojshme, procedurat për mbledhjet e administratorëve.
- 15.7 Administratorët mund të delegojnë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tyre tek persona të tjerë.
- 15.8 Administratorët informojnë Ortakun e Vetëm për ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë, raportet e organeve drejtuese apo të audituesit ligjor, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Shoqërisë.
- 15.9 Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas parashikimeve të këtij Statuti, rregulloreve të posaçme të miratuara nga Ortaku i Vetëm dhe nga legjislacioni i zbatueshëm, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
- 15.10 Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.11 Shoqëria administrohet nga 2 (dy) Administratorë ("Administratorët"), ndër të cilët mund të mos jetë domosdoshmërisht një ortak dhe do të emërohen për një kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare nga Ortaku i Vetëm. Në fund të afatit prej 5 (pesë) viteve, përveç nëse Ortaku i Vetëm ka vendosur për shkarkimin e Administratorëve para skadimit të mandatit të tyre, Administratorët mund të riemërohen ose të shkarkohen.
- 15.12 Administratorët e Shoqërisë të emëruar për një periudhë 5 vjeçare janë:
1. **Z. Mërgim Cahani**, shtetas shqiptar, lindur më 19.03.1980, në Kosovë, mbajtës i pasaportës nr. BA4288081, i cili do të veprojë në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Shoqërisë.

2. **Z. Petr Kratochvíl**, shtetas çek, lindur më 12.08.1985, në Pragë, mbajtës i pasaportës nr. 46614567, i cili do të veprojë në cilësinë e Drejtorit të Shoqërisë.

- 15.13 Shoqëria do të përfaqësohet ndaj palëve të treta nga të dy administratorët. Të dy administratorët janë të autorizuar të veprojnë në mënyrë të pavarur në të gjitha çështjet e menaxhimit të biznesit për aq kohë sa ato nuk janë në kundërshtim me planin e miratuar të biznesit, me përjashtimet e mëposhtme: (i) punësimin dhe shkarkimi do të jetë përgjegjësi e vetme e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe (ii) çdo vendim për çështjet e rezervuara të përshkruara në Statutin e Ortakut të Vetëm, do të kërkojë veprimet sipas dispozitave të parashikuara aty. Çdo veprim i Drejtorit do t'i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv paraprakisht.
- 15.14 Hapja dhe menaxhimi i llogarive bankare të Shoqërisë në banka, apo cdo lloj aktiviteti tjetër në llogaritë bankare të Shoqërisë dhe detyra të tjera të caktuara administrative do të kryhen ekskluzivisht vetëm nga Administratori/Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv **Z. Mërgim Cahani**.

Neni 16

Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësitë

- 16.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë të parashikuar në nenet 13,14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratorët duhet:
- të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut në mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesat e Shoqërisë si e tërë, dhe ne veçanti duke konsideruar ndikimin në mjedis të veprimtarisë së saj;
 - të ushtrojnë kompetencat e tyre të caktuara prej Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, vetëm për qëllimet e paracaktuara aty;
 - të konsiderojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat duhet të vendoset;
 - të parandalojnë dhe të shmangin konflikte potenciale ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
 - të ushtrojnë detyrat e tyre sipas parimit të kujdesit dhe të profesionalizmit;
 - të vënë në dispozicion çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhënat ekonomike të Shoqërisë të kërkuar nga secili prej ortakëve, brenda një afati kohor të përshtatshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhen përditësuar.
- 16.2 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblenjë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:
- u kthejnë ortakëve kontributet;
 - u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
 - shpërndajnë aktivet shoqërisë;
 - lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - japin kredi.
- 16.3 Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar zbatohen edhe për paditë sipas paragrafëve të mësipërm të këtij Neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

Neni 17

Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

- 17.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm, nëse është e nevojshme.
- 17.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e Ortakut të Vetëm.
- 17.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakut të Vetëm. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorëve dhe ekspertit kontabel të autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar.

Neni 18

Viti Financiar

- 18.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 19

Bilanci dhe Mbajtja e Llogarisë

- 19.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 19.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë sigurorese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 20

Fitimi i Shoqërisë

- 20.1 Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi shpërndahet në raport me kuotat e zotëruara.
- 20.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Neni 21

Prishja e Shoqërisë dhe Likuidimi

- 21.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë të prishë Shoqërinë.

- 21.2 Me vendim të Ortakut të Vetëm do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 21.3 Administratorët e Shoqërisë njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.
- 21.4 Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
- 21.5 Nëse Shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
- 21.6 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas përcaktimeve në Kodin Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
- 21.7 Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 (një) vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 21.8 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 22

Marrëdhëniet e Punës

- 22.1 Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave të punës dhe konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 23

Ndryshimet në Statut

- 23.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Ortaku i Vetëm, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar.

Neni 24

Shpenzimet e themelimit të shoqërisë

- 24.1 Të gjitha shpenzimet për hartimin, përkthimin dhe nënshkrimin e akteve për themelimin e shoqërisë, si dhe çdo shpenzim tjetër për regjistrimin dhe njohjen ligjore të Carvago by Gjirafa Albania SH.P.K. janë në ngarkim të shoqërisë që themelohet.

Neni 25

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

25.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtj statuti, si dhe ato që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë për çështje të lidhura me shoqërinë, do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe komunikim midis palëve.

25.2 Nëse sa më lart në pikën 25.1 nuk është e mundur, palët në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga një (1) arbitër ndërsa gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha shqipe.

Neni 26

Legjislacioni i Zbatueshëm

26.1 Çdo parashikim tjetër që nuk përmbahet nga ky Statut, do të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27

Dispozita Përfundimtare

27.1 Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshesh në lidhje me dy versionet, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

ORTAKU I VETËM

Carvago by Gjirafa L.L.C

përfaqësuar nga:

Mërgim Cahani



Jakub Šulta



Data e nënshkrimit: 15.01.2025

Articles of Association of the Limited Liability Company Carvago By Gjirafa Albania SH.P.K.

Chapter I

Founding, Scope of activity, Headquarters

Article 1

Sole Shareholder

1.1 **Carvago by Gjirafa L.L.C.** a limited liability company, established and operating according to the laws of the Republic of Kosovo, registered with company number 812112887 with headquarters at Prishtinë-Ferizaj Street, Km 6, Graçanicë, Kosovo (referred to below as "**The Sole Shareholder**"), duly represented by:

1. **Mërgim Cahani**, Managing Director, Albanian citizen, born on 19.03.1980, in Kosovo, holder of Passport with number BA4288081, major and with the full legal capacity to act, and
2. **Jakub Šulta**, Director, Czech citizen, born on 03.05.1988, in Kadan, Czech Republic, holder of Passport with personal number 48538191, major and with the full legal capacity to act,

in accordance with the legislation in force in the Republic of Albania, it has decided to establish a Limited Liability Company named **Carvago by Gjirafa Albania sh.p.k.** ("the Company") by signing this Articles of Association. The activity of this Company will be governed in compliance with Albanian legislation and the Company's Articles of Association.

Article 2

Name

2.1 The legal name of the Company is **Carvago by Gjirafa Albania SH.P.K.**

Article 3

Legal Form

- 3.1 The Company is of a Limited Liability Company form in accordance with the commercial legislation in force in the Republic of Albania.
- 3.2 The Company may be transformed into another legal form in compliance with Albanian legislation.

Article 4
Legal Grounds

- 4.1 The Company will carry out its activity in compliance with this Articles of Association, Law no. 9901 dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" ("**Commercial Law**"), as amended, and other applicable provisions of Albanian law.

Article 5
Duration of activity

- 5.1 The duration of the Company's activity is unlimited.

Article 6
Seat / Registered office

- 6.1 The registered office of the Company is at: Tiranë, Vorë, Tirana Business Park, Rruga Rinas.

Article 7
Object

- 7.1 The Company shall have the right and authority to carry out any type of activity permitted by the law in force, including specifically: the purchase and sale of vehicles and the provision of related services through an online platform, as well as the sale of CEBIA products and/or services in the Republic of Albania.

Chapter II

Article 8
Capital

- 8.1 The Company's registered capital on the date hereof shall be 100,000.00 (one hundred thousand) Lekë.
8.2 The Sole Shareholder **Carvago by Gjirafa L.L.C.** is the owner of 1 (one) share representing 100% of the share capital with a general value in the amount stated in point 8.1 above.

Article 9
Transfer of capital shares / Restrictions on transfer

- 9.1 The Sole Shareholder is the exclusive owner of all shares of the Company's registered capital.
9.2 The shares of the registered capital may be transferred, in whole or in part, to third parties through sale, donation, or any other method provided by the applicable legislation.

- 9.3 In cases of transfer of shares by contract, the terms and conditions are determined at the moment of the transfer of ownership of the share, the moment of payment of the price, in the share transfer agreement, which is drafted in written form, in accordance with the provisions of applicable legislation.

Article 10

Capital increase

- 10.1 The Company's capital may be increased at any time, in accordance with applicable legislation, by the decision of the Sole Shareholder.
- 10.2 The capital increase may also be made through the signing and payment of new capital shares by new shareholders. New shareholders shall be accepted and approved as such by the decision of the Sole Shareholder.
- 10.3 The Sole Shareholder's further contribution to the Company's capital may be in cash or in-kind (movable/immovable property, shares, or rights). A decision of the Sole Shareholder will determine the method of fulfilling the contributions.

Article 11

Decrease of capital

- 11.1 Based on the decision of the Sole Shareholder, a decrease in the registered capital shall be made in compliance with the procedures provided by the commercial legislation.
- 11.2 The Company may reduce its capital at any time by the decision of the Sole Shareholder. In any case, the capital cannot be reduced below the minimum capital value required by Commercial Law.

Chapter III

Governance Structure

Article 12

Governing bodies

- 12.1 The governing bodies of the Company are as follows:
- The Sole Shareholder – the highest decision-making body;
 - The Administrators – the highest executive body.
- 12.2 The Sole Shareholder may establish other auxiliary bodies or structures to support the Company's proper functioning.

Article 13

Internal Regulations

13.1 In accordance with the rules, procedures, and requirements provided by the applicable legislation, the Sole Shareholder approves specific regulations for the organization and proper functioning of the Company.

13.2. The regulations mentioned in point 13.1 include, but are not limited to:

- Regulations for the management of group companies;
- Regulations for the prevention of conflicts of interest;
- Code of ethics, etc.

Governing Bodies

Article 14

Sole Shareholder Resolutions

14.1 The main decisions of the Company activity are approved by resolutions of the Sole Shareholder which is the highest decision-making body of the Company entitled to issue resolutions regarding all matters of its activities. The resolution of the Sole Shareholder must be registered in a register of decisions the data of which may not be altered or erased.

14.2 Only the Sole Shareholder shall be entitled to decide on the following issues:

- a) modifications and amendments to the Articles of Association;
- b) acceptance of new shareholders (after an increase in the registered capital or a transfer of shares);
- c) to increase and/or decrease the registered capital;
- d) resolve on a merger, spin-off, dissolution, and any kind of transformation of the Company;
- e) to establish and/or close down branches and representations;
- f) to adopt the annual reports and balance sheets and approve the distribution of profit;
- g) to resolve on the internal rules for the management;
- h) to file a lawsuit against members of the bodies of the Company;
- i) to resolve on acquisition, sale, and encumbrance of real property and other immovable assets of the Company;
- j) to dissolve the Company;
- k) to determine the remuneration of the administrators;
- l) to resolve on the appointment of auditors;
- m) to determine the structural and administrative organisation of the Company;
- n) to determine the annual budgets;
- o) to approve the employment, dismissal, and other employment-related decisions i.e. promotion, salary bonuses, etc. which concern managerial positions in the Company;
- p) to approve loans and granting of securities;
- q) to decide on any other matters the solution of which has been reserved to the shareholders by the law and/or this Article of Association.

Article 15

Administration of the Company

- 15.1 In all domestic and foreign operations, the Administrators represent the Company, nominated and replaced by the Sole Shareholder.
- 15.2 The Administrators shall have full powers for the ordinary and daily management of the Company and the capacity to adopt all decisions that he may deem fit to achieve and implement the Company's scope of activity, with the sole exception of actions reserved by law, the Articles of Association or Sole Shareholder's resolutions as adopted from time to time to the shareholder(s).
- 15.3 The Administrators shall have the right to delegate, via proxy, partially or wholly their rights to a third person subject to the prior written approval of the Sole Shareholder.
- 15.4 Unless otherwise provided herein, the Administrators shall be empowered to the following activities:
- the daily management of the Company's commercial activity in accordance with the decisions and instructions of the Sole Shareholder, as applicable, approved from time to time.;
 - representation of the Company vis-à-vis third parties and vis-à-vis the public bodies;
 - the issuance of invoices, the payment of the Company's obligations;
 - the hiring and dismissal of the Company's employees and the determination of salaries, rewards, and payments for employees in accordance with the policies and guidelines approved from time to time by the Sole Shareholder,
 - taking all other actions which concern ensuring the ordinary business of the Company from the point of view of the law and the Articles of Association;
 - keeping of the accounting books as prescribed by the law and accounting principles;
 - preparing the annual financial statements of the Company and audit of the same by external auditors if this is required by the law or by resolution of the Sole Shareholder.
- 15.5 The Administrators may exercise all powers and actions, except for those that are reserved for the Sole Shareholder by law and by the Articles of Association.
- 15.6 The Sole Shareholder shall determine, by the appropriate decision, the limitations of powers, the scope of powers for each administrator, and, if necessary, the procedures for the meetings of the administrators.
- 15.7 The Administrators may delegate part or all of their powers to other persons.
- 15.8 The administrators shall inform the Sole Shareholder about the progress of the Company's activities and, at their request, must provide the annual accounts, including consolidated accounts, reports on the status and progress of the Company's operations, reports from the governing bodies or the legal auditor, as well as any other internal documents of the Company.
- 15.9 If the administrators act contrary to their duties and violates professional standards, according to the provisions of the Articles of Associations, the specific regulations approved by the Sole Shareholder, and

the applicable legislation, the administrators are obliged to compensate the Company for damages resulting from the violation and to transfer any personal profit they or their related parties have made from these improper actions.

15.10 The Administrators bear the burden of proof to demonstrate that they have performed their duties properly and according to the required standards. When more than one administrator commits the violation, they are jointly liable to the Company.

15.11 The Company is managed by 2 (two) Administrators ("the Administrators"), who do not necessarily have to be a shareholder and will be appointed for a term of 5 (five) years by the Sole Shareholder. At the end of the 5 (five) year term, unless the Sole Shareholder has decided to remove the Administrators before the expiration of their mandate, the Administrators may be reappointed or removed.

15.12 The Administrators of the Company, appointed for an initial term of 5 years, are:

1. Mr. **Mërgim Cahani**, Albanian citizen, born on 19.03.1980, in Kosovë, holder of passport no. BA4288081, who shall act in the capacity of the Chief Executive Officer of the Company "CEO".
2. Mr. **Petr Kratochvíl**, Czech citizen, born on 12.08.1985, in Prague, holder of passport no. 46614567, who shall act in the capacity of the Director of the Company.

15.13 The Company shall be represented to third parties by the two administrators. The two administrators shall be authorized to act independently in all matters of business management as long as they do not contravene with the approved business plan, with the following exceptions: (i) hiring and firing shall be the sole responsibility of the Chief Executive Officer and (ii) any decision on reserved matters described in the Sole Shareholder's Articles of Association (Charter) shall require action in accordance with the provisions set forth therein. Any action of the Director shall be notified to the Chief Executive Officer beforehand.

15.14 The opening and management of the Company's bank accounts in banks, or any other type of activity in the Company's bank accounts and other certain administrative tasks will be performed only by the Administrator/CEO **Mr. Mërgim Cahani**.

Article 16

Fiduciary Duties and Liability

16.1 In addition to general fiduciary duties laid down in Articles 13, 14, 15, 17, and 18 of the Commercial Law, the Administrators must:

- a. Perform their duties established by the Commercial Law or the Articles of Association in good faith and in the best interest of the Company as a whole, paying particular attention to the impact of its operation on the environment;
- b. Exercise their powers granted to them by the Commercial Law or the Articles of Associations, only for the purposes established herein;
- c. Give adequate consideration to the matters to be decided;
- d. Prevent and avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the Company;
- e. Exercise due diligence and care in the performance of their functions.

- f. Provide any information regarding business and economic data requested by any of the shareholders within a reasonable time and in any case not later than 7 days. Information data must be updated.
- 16.2 In particular, but not exclusively, the Administrators shall be obliged to compensate the company for the damage, if they carry out contrary to the Law the following transactions:
- a. return contributions to shareholders;
 - b. pay interest or dividends to shareholders;
 - c. distribute the company's assets;
 - d. let the company to do business when, according to its financial situation, it is foreseeable that it would be unable to pay its debts;
 - e. grant loans.
- 16.3 Article 92, paragraph 6 of the Commercial Law shall also be applicable to claims under the preceding paragraphs of the present Article. These claims must be submitted within 3 years of the commitment of the violation, or its discovery.

Article 17

Chartered Accountant

- 17.1 The chartered accountant(s) shall be appointed by resolution of the Sole Shareholder if necessary.
- 17.2 The expert is responsible for reviewing all accounting documentation related to the economic and commercial activities of the company, including the annual documentation and that related to the periodic audits conducted by them when they have been assigned and have carried out such tasks by the Sole Shareholder.
- 17.3 At the finalisation of the audit, the authorised accountant prepares a written report on the results of the annual financial statements as well as on the periodic audits conducted, which they are required to present and deliver on time to the Sole Shareholder. The annual financial statements, inventory, the report of the Administrators, and the authorized accountant's report are approved by the Sole Shareholder in accordance with the Commercial Law.

Article 18

Financial year

- 18.1 The financial year of the Company activity coincides with the calendar year, beginning on 1st January and ending on 31 December of each year.

Article 19

Balance Sheet and Accounting

- 19.1 The balance sheet of the Company is examined by the Sole Shareholder and should be prepared to be submitted to tax authorities before the end of March of the consecutive year.
- 19.2 Accounting books should be drafted in Albanian language and local currency (lekë). The Company may keep separate accounts in foreign currency, which amounts need to be converted, every month in local currency.

- 19.3 The Company may receive financing from financial institutions operating in Albania or abroad. For this reason, the Company may pledge its shares as a guarantee or may decide to mortgage its real estate, by resolution of the Sole Shareholder.

Article 20

Company Profit

- 20.1 The Sole Shareholder has the right to receive the share of profit declared in the company's financial statements. The profit is distributed in proportion to the owned shares.
- 20.2 The company may distribute profits to the shareholders only if, after the payment of dividends:
- the company's assets fully cover its liabilities;
 - the company has sufficient liquid assets to meet the obligations that become due within the next 12 months.

Article 21

Dissolution and Liquidation

- 21.1 The Sole Shareholder may resolve to dissolve the Company.
- 21.2 By resolution of the Sole Shareholder shall be appointed a liquidator or a group of liquidators that will handle the liquidation procedures.
- 21.3 The Administrators of the Company notify the National Business Center of the names of the first liquidators and their powers to represent the Company, along with the relevant documents.
- 21.4 The liquidator assumes the rights and obligations of the administrators from the date of their appointment.
- 21.5 If the Company appoints more than one liquidator unless the appointment act specifies that they act separately, the liquidators exercise the rights and obligations jointly according to this law. The liquidators may authorize one of them to carry out actions of a specific category.
- 21.6 The duty of the liquidators is to close all of the Company's operations, collect outstanding receivables and unpaid contributions, sell the Company's assets, and settle the creditors in accordance with the order of priority, as per the specifications of the Civil Code. The liquidator may also carry out new commercial actions to complete an unfinished transaction.
- 21.7 The liquidator prepares a balance sheet of the company's situation at the moment of opening the liquidation and a final balance sheet at the moment of closing these procedures. If the liquidation procedure lasts more than 1 (one) year, the liquidator also prepares the annual financial statements of the company. The balance sheets are approved by the Sole Shareholder.
- 21.8 The Company continues to exist as a legal entity for the purposes of liquidation until the completion of this process. During this procedure, the phrase "in liquidation" must be added after the name of the Company.

Article 22

Employment Relations

- 22.1 Employment relations are regulated through employment contracts and in accordance with the Labor Code of the Republic of Albania.

Article 23

Changes to the Articles of Association

- 23.1 The provisions of the Articles of Association can be modified by the Sole Shareholder in compliance with the provisions of the commercial legislation.

Article 24

Company Incorporation Costs

- 24.1 All expenses related to the drafting, translation, and signing of the acts for the incorporation of the company, as well as any other expenses for its registration and legal recognition of Carvago By Gjirafa Albania SH.P.K, shall be borne by the company being established.

Article 25

Dispute Resolution

- 25.1 Any disputes that may arise regarding the interpretation and/or implementation of the Articles of Association, as well as those that may arise between the shareholders or between the shareholders and the company concerning matters related to the company, shall be resolved amicably through communication between the parties.
- 25.2 If resolution, as outlined in point 25.1, is not possible, the parties, concerning their relations with the company, shall refer the matter to arbitration under the framework of the American Chamber of Commerce in Kosovo, in accordance with the arbitration rules of the Arbitration Center of the American Chamber of Commerce in Kosovo. The Arbitration Tribunal shall consist of one (1) arbitrator, and the language of the arbitration shall be Albanian.

Article 26

Applicable Law

- 26.1 Any provisions not included in the Article of Association shall be governed by the applicable legal provisions in force in the Republic of Albania.


Article 27

Final Provisions

- 27.1 This Articles of Association is drafted and signed in 2 (two) original copies in English and Albanian. In case of discrepancies between the two versions, the Albanian version shall prevail.

SOLE SHAREHOLDER
Carvago by Gjirafa L.L.C
represented by:

Mërgim Cahani

A blue ink signature of Mërgim Cahani, consisting of a stylized 'M' followed by a horizontal line.

Jakub Šulta

A blue ink signature of Jakub Šulta, featuring a large, sweeping 'J' followed by a horizontal line.

Date: 15.01.2025

